



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 457 Prot.

Tiranë, më 07.02 2024

URDHËR

Nr. 6 dt. 07.02 2024

“PËR

FILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR DHE DATËN E ZHVILLIMIT TË
ZGJEDHJEVE PËR KËSHILLAT E STUDENTËVE TË FAKULTETEVE DHE
KËSHILLIN E STUDENTËVE TË UNIVERSITETIT”

Në zbatim të nenit 39 dhe 99 pika 1 dhe 3 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenit 23 dhe 96 të Statutit të UST-së, nenit 14 të Rregullores së UST-së, nenit 6, 7, 8, 9, 19, 25 të Rregullores së Funkcionimit të Këshillave të Studentëve në Universitetin e Sporteve të Tiranës, shkresës nr.297/2 prot., datë 29.01.2024 të Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët “Vënien në dijeni për përfundimin e mandatit të Këshillave Studentorë UST”,

URDHËROJ:

1. Nisjen e procedurave për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, për krijimin e Këshillave të Studentëve të Fakulteteve dhe Këshillin e Studentëve të Universitetit, pas konstatimit të përfundimit të mandatit të tyre, duke ndjekur hapat e mëposhtëm për një proces të drejtë dhe të rregullt ligjor.
2. Periudha e fushatës zgjedhore do të jetë nga data 07.02.2024 deri më 07.03.2024.
3. Çdo grup mësimor (seminari) në çdo Fakultet do të zgjedhë nga një përfaqësues në Asamblenë e Këshillit Studentor të Fakultetit. Votimi do të kryhet me shumicë të thjeshtë votash ose në rast të një kandidati të vetëm me (50+1), në bazë të vetëkandidimit ose propozimit nga njëri-tjetri. Votimi do të kryhet në datat 11 dhe 12 mars 2024.
4. Më pas Asambleja e Këshillit Studentor të çdo Fakulteti do të zgjedhë Këshillin Studentor të Fakultetit të përbërë nga 6 (gjashtë) anëtarë, me votim të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë. Kandidatët për anëtarë të Këshillit Studentor të Fakultetit vetëkandidohen ose propozohen nga anëtarët e zgjedhur të Asamblesë së Këshillit Studentor të Fakultetit. Data e zgjedhjeve për Këshillat e Studentëve të Fakulteteve është 15.03.2024.

5. Në mbledhjen e parë të Këshillit të Studentëve të cdo Fakulteti do të zgjidhet me shumicë të thjeshtë kryesia e Këshillit, e përbërë nga kryetari, nënkryetari dhe sekretari në datë 18.03.2024.
6. Këshillat Studentorë të secilit fakultet të dalë nga zgjedhjet, në mbledhjen e parë, brenda një jave nga zgjedhja, duhet të zgjedhin kryesinë e këshillit të tyre, si dhe të zgjedhin nga një anëtar secili këshill, për formimin dhe konstituimin e Këshillit të Studentëve të UST deri në 22.03.2024.
7. Këshilli i Studentëve të cdo Fakulteti ka për detyrë të zgjedhë nga 1 (një) përfaqësues për cdo Fakultet, i cili do ta përfaqësojë në Këshillin e Studentëve të Universitetit.
8. Këshilli i Studentëve të Universitetit, përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, 3(tre) prej të cilëve janë kryetarët e Këshillave të Studentëve të Fakulteteve dhe 3(tre) anëtarë të zgjedhur sipas pikës 7 të këtij Urdhëri.
9. E gjithë procedura e zgjedhjeve të organeve për cdo Këshill Studentor do të mbyllet brenda datës 22.03.2024.
10. I gjithë procesi zgjedhor do të mbikqyret nga Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët.
11. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhëri Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët, Drejtorja e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët, Drejtorja e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko Shkencore.
12. Ky Urdhër i përcillet Administratorit të UST-së për mbështetjen me bazë materiale dhe financiare për zhvillimin e zgjedhjeve për Këshillat e Studentëve në UST.
13. Ky Udhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. Dr. Agron KASA

